



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.17/2011
Prishtinë, më 21.06.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha-Shala, Fikrim Damka, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri dhe Myzejene Selmani.

Munguan : Ramiz Kelmendi, Biserka Kostić dhe Berat Buzhala.

Të ftuarit për raportim: Mimoza Kusari – Lila, ministreshe e Tregtisë dhe Industrisë; Florent Bakija dhe Dardana Halimi - MTI.

Pjesëmarrës të tjerë: Haxhi Gashi-USAID/ Deloitte; Ganimete Heseti- KDI dhe Tarkan Kosova - OSBE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 14.06.2011;
3. Raportim i ministres se ministrisë se Tregtisë dhe Industrisë, për CEFTA (E ftuar znj.Mimoza Kusari – Lila, ministreshe e Tregtisë dhe Industrisë);
4. Miratimi i Raportit me Rekomandime të Projektligjit nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për tregtinë e brendshme;
5. Miratimi i Raportit me Rekomandime të Projektligjit nr.04/L-014 për efciencen e energjisë;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 14.06.2011

Procesverbali nga mbledhja e datës 14.06.2011 u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i ministres se ministrisë se Tregtisë dhe Industrisë, për CEFTA (E ftuar znj.Mimoza Kusari – Lila, ministreshe e Tregtisë dhe Industrisë)

Kryetari – tha se siç është paraparë për këtë pikë të rendit të ditës, është Raportim i ministres se ministrisë se Tregtisë dhe Industrisë, për CEFTA. Ne kemi ftuar znj. Kusari – Lila, e cili do të paraqet një ekspozitë të shkurtër për CEFTA-n edhe për problemet dhe sfidat e kësaj ministrie lidhur me mos zbatimin e marrëveshjes rajonale të tregtisë së lire (CEFTA). Ne vazhdim Kryetari – theksoj se për vështirësitë rreth njohjes së vulave doganore që pengojnë tregtinë me disa vende të CEFTA-së, dhe pyeti se cili është aktiviteti i MTI në lidhje me këtë sfidë? Agjencia për Standardizim e Kosovës nuk është anëtare e organizatës evropiane ose ndërkombëtare të standardizimit, pyeti se cila është gjendja në ASK dhe çfarë hapash keni ndërmarr që ASK të anëtarësohet në Organizatën Evropiane ose ndërkombëtare të Standardizimit? Ligji për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësimin e konformitetit ende duhet të shqyrtohet me qëllim të përfshirjes së acquis horizontale të vitit 2008 për marketing të produkteve, pyeti se a keni parapare ndonjë ndryshim plotësim të këtij ligji në këtë vit? Megjithatë përafrimi me acquis në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave është e kufizuar dhe kapaciteti administrativ për transpozim dhe zbatim është i pamjaftueshëm, çfarë hapash keni ndërmarr në lidhje me këtë çështje? Nuk ka pasur progres në të drejtën e themelimit të kompanive, përputhshmëria me standardet e BE-së rreth njohjes së kualifikimeve profesionale është e kufizuar, cili është opinionimi Juaj për të themelimin e të drejtës së kompanive? Projektligjet rreth Patentave, Markave Tregtare dhe Dizajnit Industrial tanime janë proceduar në Kuvend nga Qeveria, a garantoni se kanë nivelin të lartë të përputhshmërisë me acquis, Marrëveshja TRIPS dhe standardet tjera ndërkombëtare? Po ashtu pyeti se a ka MTI –ja ndonjë Strategji përkatëse për zhvillimin e NVM-ve? Kosova nuk ka ligj ose strategji për rezervat e naftës, niveli i rezervave të naftës së Kosovës është i panjohur, pse mungon një Strategji e tillë dhe cili është niveli i naftës në vend?

Mimoza Kusari – Lila (zv.kreyminstre/ministreshe në MTI) – theksoj se qysh prej 4 Dhjetorit 2008, është fakt i njohur që, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina në mënyrë unilaterale kanë bllokuar mallrat me origjinë kosovare dhe përdorimin e territorit të tyre si transit për në vendet e BE-së. Kjo ka ndodhur menjëherë pasi që Kosova ka ndryshuar vulat e saj doganore duke zëvendësuar ato të UNMIK-ut me vulat e Doganave të Kosovës. Kur Kosova iu bashkua Marrëveshjes së CEFTA-s, në fund të vitit 2006, shkëmbimet tregtare në mes të Kosovës dhe Serbisë po rriteshin ndjeshëm. Gjatë vitit 2006 dhe 2007 Kosova eksportonte në Serbia mallra me vlerë rreth €20 milion. Kjo shifër ishte për rreth 150% më e lartë se në vitin 2005 kur Kosova kishte eksportuar vetëm €8 milion. Gjatë asaj kohe, eksportet e Serbisë në Kosovë shënuan rritje poashtu. Në vitin 2005, Serbia eksportoiti në Kosovë mallra në vlerë prej €152 milion. Deri në fund të vitit 2008, eksportet e Serbisë në Kosovë janë rritur me 25% në €208 milion. Bllokimi i mallrave kosovare, në fund të vitit 2008, pati ndikim negativ të menjëhershëm në ekonominë tonë. Deri në fillim të vitit 2011, kur produktet tona ishin të bllokuara për më shumë se dy vite, eksportet e Serbisë në Kosovë janë rritur për 25%, prej €208 milion në 2008, në €260 milion në

fund të vitit 2010. Vitin e kaluar Bosnja e Hercegovina eksportoi në Kosovë mallra në vlerë prej më shumë se €82 milion. Përderisa eksportet e Kosovës me të gjitha vendet tjera të rajonit anëtarë të CEFTAs janë rritur vazhdimisht, mallrave kosovare nuk iu është lejuar as kalimi transit nëpër territoret e këtyre dy shteteve. Për shkak të kësaj bllokade bizneset tona të orientuara në eksport, siç janë prodhuesit e verës, janë duke humbur miliona euro në kostot e transportit. Për më shumë, veprimet tona tregtare dhe ekonomike udhëhiqen nga Neni 119 i Kushtetutës së Kosovës e cila siguron ekonominë e lirë të tregut, ambient ligjor të favorshëm dhe lirinë e aktivitetit ekonomik. Nëse konkurrenca e lirë rrezikohet përmes pozicioneve dominante në treg, ne jemi të detyruar të veprojmë në mbrojtje të saj. Gjithashtu, ne jemi të mandatuar të sigurojmë të drejta të barabarta ligjore për të gjithë investitorët dhe kompanitë kosovare dhe të jashtme. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës do të pres rezultatet e raundit të ardhshëm të bisedimeve të dialogut teknik në mes Kosovës dhe Serbisë. Nëse gjatë raundit të ardhshëm të bisedimeve në Korrik, Serbia nuk e ndryshon vendimin e saj për ti pranuar vulat e Doganave të Kosovës, Kosova do të vendosë masa të plota reciprociteti për produktet me origjinë nga Serbia. Sa i përket reformave e biznesit të cilat ka filluar ti udhëheq MTI-ja kanë për qëllim përmirësimin e ambientit biznesor për të gjithë investitorët në Kosovë. MTI është duke rregulluar çështjen e mbylljes së biznesit në kuadër të një reforme më të gjerë e cila përfshin regjistrimin e biznesit, lejet e ndërtimit, regjistrimin e pronës, çështjet e kredive financiare dhe mbrojtjen e investitorëve. Në afat të shkurtër në kemi arritur që të hapim 22 “one stop shops” në shumicën e qyteteve të Kosovës. Këto qendra të bizneseve komunale do të lehtësojnë procedurat dhe shkurtojnë kohën për regjistrim dhe mbyllje të bizneseve joaktive. Në planin afatmesëm, deri më 2014, numri i licencave për bizneset do të ulet për 50%. MTI ka finalizuar Strategjinë për NVM. Kjo strategji pritet që deri në fund të muajit Qershor të miratohet nga Qeveria e Kosovës. MTI është në proces të transpozimit të Direktivës së Qasjes së Re dhe Direktivave tjera të BE-së. Në linjë me parimet e Regulativës 765/2008/EC dhe 768/2008/EC është draftuar Ligji për Kërkesat Teknike të Produkteve dhe Vlerësim të Konformitetit. Projektligji i është dërguar Komisionit Evropian në Bruksel për komente. Kuvendi i Kosovës pritet ta pranojnë draftin e parë të këtij projektligji në javët e ardhshme. Pas aprovimit të Ligjit mbi Standardizimin 03/L-144, MTI ka aprovuar UA për Funksionalizimin e Komiteteve Teknike. Komitetet Teknike kanë aprovuar adoptimin e 1387 standardeve të reja EN si standarde SK. Për shkak se Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara, marrëveshja e bashkëpunimit me Drejtoratin e Përgjithshëm të Standardizimit në Shqipëri është burim i vetëm i furnizimit me standarde evropiane dhe ndërkombëtare. Marrëveshja është stabile, funksionale dhe i mundëson Agjencisë Kosovare të Standardizimit të transpozojë Standardet Evropiane për tregun e Kosovës. Ligji për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës do të kalojë deri në fund të vitit 2011. Poashtu Strategjia për rezervat e naftës do të miratohet nga Qeveria e Kosovës deri në fund të vitit 2011. Niveli i rezervave të naftës në Kosovë është i njohur. Kosova ka rezerva të naftës vetëm për 4 ditë. Ligji i ri dhe Strategjia e re do t'i mundësoj MTI-së që të punojë në drejtim të arritjes së nivelit të kërkuar nga Traktati i Energjisë sipas të cilit Kosova duhet të ketë rezerva të naftës për 90 ditë. Tri Ligjet që rregullojnë fushën e të drejtave të pronësisë industriale (DPI) -Ligji për Marka Tregtare, Ligji për Dizajn Industrial dhe Ligji për Patentë - e kanë marrë miratimin e Qeverisë dhe së shpejti pritet të kalojnë në Kuvendin e Kosovës. Deri në fund të Korrikut të vitit 2011, do të themelohet Këshilli për Pronësinë Intelektuale.

Teuta Sahatqija – tha sa i përket reciprocitetit edhe aplikimit të taksës 10% ka qenë vetëm një fazë kalimtare sepse si e tillë, nuk ndikon në përmirësimin e raporteve tregtare me Serbinë por vetëm në shtrenjtimin e mallrave. Kur të aplikohet reciprociteti ne së pari duhet ti kemi rezervat që të jemi të furnizuar mirë, ashtu që të mos ndikoj së paku në një afat disa mujor ndikimi i daljes së importit sidomos të drithërave e tjerave në ngritjen e çmimeve. Në qoftë se dëshirojmë të vejmë reciprocitet, a jemi ne si shtet të gatshëm që ti hyjmë këtij veprimi? Dhe ju si ministri a keni ndonjë alternativ e cila do të aplikohet në këtë rast? Shpjegoni ku është problemi, pse ekzistojnë këto probleme me tregtinë më Shqipërinë? Sa i përket ambientit të biznesit ne së

fundmi e kemi kaluar projektligjet për Shoqëritë tregtare dhe Tregtinë e brendshme të cilat kanë qenë projektligje që i kemi diskutuar gjatë, ku kemi pas shumë dilema, se sa mund të zbatohen. Andaj, këto dy ligje duhet së shpejti të rirregullohen të ndërrohen komplet sepse ka pas shume vende ku kishin kolizion me inspektorate të ndryshme, kolizion me leje të ndryshme prej Komunës etj.

Hashim Deshishku – tha se keni premtuar që do ti aprovoni taksat doganore për Serbinë prej 10 %, me datë 14 apo 15 qershor, ju thatë më herët se Serbia i ka ulë çmimet për 10% për eksport atëherë si do te veproji?

Visar Ymeri – Pyeti, se pse nuk ka qenë e mundur që të respektohet ajo datë që e keni paralajmëruar më 15 qershor për masat e reciprocitetit? A mendoni se taksa doganore e cila shqiptohet nga Qeveria e Kosovës për prodhuesit nga Serbia mund të zbatohen? Çka nëse sekretariati i CEFTA-së e anulon këtë? Ju si Ministri, si Qeveri, a jeni koordinuar edhe me Ministrit tjera, edhe a ka ndonjë plan Qeveria si ta zgjedh këtë çështje, me qenë se bllokimi i mallrave nga Serbia do të duhej të ndodhte patjetër, atëherë çka do të bëjë Kosova në këtë drejtim? Ministria e juaj me qenë se e mbulon edhe sektorin e industrisë a ka plan dhe platformë se si do të punohet edhe me ministri të tjera në mënyrë që t'a fillojmë më e industrializuar vendin? Theksoj se Kosova do të duhet të hartojë edhe legjislacionin e nevojshëm edhe kushtet tjera për rezervat shtetërore gjë që kishin me qenë mjaftë të dobishme në këtë drejtim. Sa i përket ligjeve të tjera që kanë të bëjnë më krijimin më të mirë të mjedisit për biznese dhe veçanërisht sektori i prodhimit është duke lënguar, vetëm që si ka këto ligje apo ka çështje tjera të cila do të duhej të përmirësohen, qoftë nëpër mes ndihmës së drejtpërdrejtë për sektor të caktuar qoftë edhe nëpërmes subvencioneve të drejtpërdrejta, jo vetëm në prodhimin primar në bujqësi por edhe në prodhimin sekondar i cili do të nxiste një zhvillim më të hovshëm ekonomik të vendit.

Myzejene Selmani - tha në bazë të Raportit të Progresit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është obliguar të raportoj brenda Komisionit Parlamentar, duke e marrë parasysh gjendjen faktike dhe propozimet e Ministres për çështjen e taksës doganore, duhet të kemi ndoshta edhe pak pritje se i kemi bisedimet të cilat janë duke u zhvilluar edhe në aspektin e marrëveshjes së CEFTA-së në mes të Kosovës dhe Serbisë për tregtinë e lirë, edhe nëse pritet deri te një konkludimi në mes të përfaqësuesve tanë edhe në mes të përfaqësuesve të Serbisë për lëvizjen e lirë dhe të lëvizjen e mallrave atëherë kishte me qenë më e rrugës të pritet sepse mund të ketë edhe ngritje të çmimeve. Për reformat e të bërit biznes edhe strategjia e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, Komisioni parlamentar i ka miratuar 3 projektligje të cilat kanë të bëjnë me këtë sektor, është e vërtetë se ndoshta nuk kanë qenë ligje shumë të mira, por është detyra e shpejtë e marrjes së postit të Ministres sepse që të bëhen ligje të mira duhet bukur shumë punë dhe besoj se pas një kohe Ministria do të hynë në rishqyrtim të këtyre ligjeve për amendamentin më të mirë. Mirëpo vetëm Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me këto ligje nuk duhet të jetë vetëm ajo e cila do të mund ta bëjë Kosovën, në të mirë që të bëhet biznes në Kosovë, është edhe Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë edhe gjykatat. Ndërsa sa parkete strategjisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nëse vjen në Kuvend, ku Ministresha, e potencoj se janë duke punuar sepse çështja e ndërtimit të biznesit në ndërmarrje të vogla dhe të mesme është parim kryesor për Kosovën, sepse çështja e parë është çështja e bizneseve të vogla dhe të mesme dhe ti përkrahem në anën ligjore edhe me infrastrukturë sekondare. Prandaj çështja e zhvillimit ekonomik, rritja GDP-së dhe zbatimit të ligjeve është primare për arsye se gjendemi në një zhvillim ekonomik të ngadalshme të vendit.

Mimoza Kusari – Lila (zv.kreyminstre/ministreshe në MTI) – sa i përket reciprocitetit të plotë dhe faktit se a është planifikuar rezerva, në kuadër të zbatimit të marrëveshjes është vlerësuar dhe është shikuar në detaje lista e produkteve të importuara. U përmend edhe më heret që brenga kryesore ka qenë në bllokimin e plotë që mund të shkaktoj një shtrenjtim të madh dhe një

çrregullim në tregun e Kosovës, sidomos në mallrat e konsumit të gjërë, në veçanti gruri por edhe disa të tjera produkte të cilat janë përdorur si lëndë e parë në kuadër të procesit të prodhimit. Ne në ndërkohë kemi pasur mjaft kohë që të shikojmë me prodhues edhe me organizata, asociacionet me vendet fqinje gjegjësisht me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Kroacinë, edhe është cilësuar se në kuadër të bllokimit të mallrave, për konsumin e gjërë nuk do të ketë krizë edhe kriza e vetme dhe problemet e vetme do të jenë preferencat e konsumatorëve të cilët mund të mos kenë qasje në ato produkte. Sa i përket kontrabandimit nga Pika 1 dhe 31, nuk mund të them saktë se çfarë ndodh për shkak se kontorllohen nga EULEX-i, të vetmin raport të cilin e kemi pasur ka qenë importi me derivate nga Pika 1 dhe 31, por jo në raport me produktet e konsumit të gjërë d.m.th nuk ka pasur ndonjë lëvizje të sasisë së mallrave që vinë nga Serbia, përveç faktit që u përmend se që Serbia ka tentuar të ndihmoi prodhuesit e vet duke e zbritur çmimin nga 10% i cili është faturuar në kuadër të po të njejtës temë. Sa i përket bashkëpunimit tregëtar me Shqipërinë, në vazhdimësi është deklarua pra tri vite radhazi nga viti 2009-2011 që Shqipëria ka aplikuar çmime referente për produktet e Kosovës, në kuadër të kësaj do të bëjë një vizitë në Shqipëri me ç'rast do të takohem me kryeministrin Berisha, me Ministrin e financave Bode, dhe me Ministrin e Ekonomisë Naço, dhe që me te tre do të diskutohet heqja e tërësishme e çmimeve referente. Deri tani kanë tri produkte karakteristike të cilat kanë shkaktuar krizë në Kosovë, rrushi, patatet dhe në këtë vitq qumështi, i cili është normalizuar pak. Sa i përket respektimit të datës z. Ymeri, që në raport është ende tek CEFTA, paralajmërimi i datës nuk është bërë vetëm pasi që nuk është mbajtur takimi në rundin e bisedimeve në mes të Prishtinës dhe Beogradit, që ka qenë i paralajmëruar me 14 dhe 15 qershor, ky rund është anuluar dhe është shtyrë për një periudhë tjetër, është thënë ose fundi i qershorit ose mesi i korrikut, por është bërë e ditur e keni edhe një letër e cila ju është dorëzuar edhe kryenegociatorit z.Kuper, por edhe palëve të përfshira në këtë proces, Në qoftë se ne rundin e korrikut nuk ka rezultat atëherë Kosova shkon me reciprocitet të plotë d.m.th ne nuk do të presim edhe një afat tjetër. Sa i përket ligjeve është e vërtet se po ballafaqohemi ende me problemet e zbatimit sidomos në raport me ligjet të cilat janë miratuar. Sa i përket inspektoratit por edhe kundërthëniet të cilat ekzistojnë në ligjet aktuale apo në përplasjet të cilat ekzistojnë nuk do të jetë një proces i letë për arsye se si zbatim i ligjit sidomos aplikimi i gjobave, nuk po zbatohet vetëm nga Ministria e Industrisë dhe Ekonomisë por edhe nga niveli Komunal, dhe nuk mund të fillojë zbatimi i ligjit pa pasur edhe një koncenzus të përgjithshëm. Sa i përket rezervave të shtetit, ne e kemi bërë një zgjidhje, në kuadër të administratës aktuale kemi krijuar departamentin e rezervave shtetërore, janë rialoku tre punëtorë në kuadër të Ministrisë të punojnë për këtë departament dhe me 23 qershor është caktuar takimi i parë ndërqeveritar i përfaqësuesve të gjithave ministrive që përcaktohen me ligj që të marrin pjesë në përgatitjen e planit për rezervat e shtetit, ku deri ne fund te korrikut pritet finalizimi i këtij plani. Sa i përket planit për riaktualizimin e industrisë, përmenda në fillim strategjia e industrisë e cila është përgatitë nga Ministria e Industrisë dhe Tregtisë në legjislacionin e kaluar është një strategji e cila nuk ka kaluar në Qeveri dhe është miratuar vetëm prej Ministrisë, kërkesa e raportit të progresist ka qenë që kjo strategji të miratohet në Qeveri, për tu miratuar në Qeveri ne kemi bërë një rishikim strategjisë dhe kemi vlersuaar se ka shumë hapësirë për tu plotësuar. Pajtohem me z.Selmani që është një proces më kompleks përfshin rendin dhe ligjin, përfshin edhe ministrinë tjera edhe dikaster tjerë, përfshin edhe pushtetin lokal, megjithatë në kuadër të strategjisë për zhvillim ekonomik dhe prioritetet e përcaktuara ne e kemi përfshi edhe Ministrinë e Drejtësisë për të krijuar një linjë më të përshpejtuar të lëndëve.

Visar Ymeri – tha se te çështjet e mardhënieve tregtare me Serbinë, sepse me sa duket disa pyetje u anashkaluan sa janë të zbatueshme masat e reciprocitetit, pra a do të vije Qeveria e Kosovës në fund të korrikut në pozicionin që ne e deshëm, por EULEX-i nuk deshi? E dyta, është që Qeveria e Kosovës që po pret që të përfundojnë negociatat me Serbinë, e mandej të vendosen përmasat e reciprocitetit, sigurisht që Serbia po që se ne nuk e nxisim ajo nuk do të vepron edhe deri kur duhet ta pret Kosova që Serbia të bëhet e mirë, sepse Serbia kurr nuk do të bëhet e mirë. Dhe a mendoni ju si Ministër që do të ishte më mirë që njëherë të zbatohen masat e reciprocitetit e mandej

ta kushtëzohet Serbinë? Për sa i përket strategjisë për industrializim, konsideroj që kontaktin me industrialistët gjerman është shumë i mirë, ishte dashur që të bëhen plane edhe me shtet tjera pra me vende të tjera të botes për shkak se është e domosdoshme që Kosova përfundimisht të lëviz përpara.

Sala Berisha Shala - theksoj se ishte përshtypje e mirë vizita e industrialistëve gjerman gjatë këtij viti në Kosovë, ndërsa pyetja ka të bëjë se a keni identifikuar industrinë e tilla në Kosovë? A kanë të bëjnë këtu edhe me zonat industriale apo kanë të bëjnë edhe me industrinë të cilat nuk janë të aktivizuara?

Mimoza Kusari – Lila (zv.kreymministre/ministreshe ne MTI) – sa i përket pikave 1 dhe 31 vlerësimi i përgjithësimi i importit që është bërë në Kosovë nuk i ka përfshirë këto dy pika, pra nëse flasim për vitin 2010, dhe 260 milion rritje të importit nga ana e Serbisë do më thënë nuk përfshihet pika 1 dhe 31, për shkak se në këto dy pika nuk bëhet drejtpërdrejt çdo doganim i mallrave, por bëhet brenda në jugun e Mitrovicës. Prandaj ne kur flasim për aplikimin e plotë të reciprocitetit duhet të bëhet në të gjitha pikat e doganave ku institucionet kanë kontroll të plotë. Nga BE është dhënë vetëm një afat, korriku nuk po them që është data e saktë por është paraparë mesi i korrikut dhe nuk jemi duke e pritur me vullnetin pozitiv reagimin e Serbisë, duke e ditur se nëse e presim me pozitivitet kjo nuk do të ndodhë kurrë por është kusht që i është vënë Serbisë nga ana e BE-së, prandaj në këtë aspekt për ne palë nuk është Serbia, por palë janë institucionet e BE-së. Sa i përket industrisë dhe mallrave të industrializuara ne jemi duke i shikuar politikat fiskale të cilat janë pjesë e strategjisë dhe projekteve zhvillimore të cilat do të jenë në funksion prej janarit të vitit 2012 dhe ato përfshijnë lirin nga dogana dhe të materialit gjegjësisht lëndës së parë, e cila përdoret për prodhim në Kosovë. I kemi identifikuar industrinë të cilat në Kosovë duhet të rivitalizohen, fokusi është tek industrinë të cilat marrin forcë të madhe të punës intensive kryesisht është diskutuar me kompanitë të cilat janë në sektorin e tekstilit sepse krijimi i mardhënies së punës në kompanitë e tekstilit është shumë më i lirë se sa në industrinë tjera. Por edhe një herë po e cekim se nëse nuk zhbllkohet bllokada e cila i është vënë Kosovës, do të ketë shumë vështirësi që çfarëdo industrie të përparojë në Kosovë, për shkak se eksporti jashtë Kosovës dhe bllokada e cila i është vënë ka shkaktuar probleme shumë të mëdha.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Ministrat e linjave përkatëse do të ftohen të raportojnë ne Komision, për punën e tyre dhe në plotësimin e sfidave të evindetuara nga Raporti i Progresit.

4. Miratimi i Raportit me Rekomandime të Projektligjit nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për tregtinë e brendshme

Kryetari – Theksoj se Raporti me Rekomandime të Projektligjit nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për tregtinë e brendshme, pas kthimit pa ndonjë vërejtje nga Komisionet përherëshme, duhet të miratohet dhe të procedohet në mbledhje plenare për lexim të dytë.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me Rekomandime të Projektligjit nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për tregtinë e brendshme.

4. Miratimi i Raportit me Rekomandime te Projektligjit nr.04/L-014 për eficiencen e energjisë

Kryetari – Theksoj se Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr.04/L-014 për eficiencen e energjisë, pas kthimit pa ndonjë vërejtje nga Komisionet përherëshme, duhet të miratohet dhe të procedohet në mbledhje plenare për lexim të dytë.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr.04/L-014 për eficiencen e energjisë.

5. Të ndryshme

a) Mbledhja e radhës

Myzejene Selmani- Kërkoj me qene se është kryetare e Grupit Parlamentar të AKR-së dhe i duhet të merr pjesë rregullisht në mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit, që mbahen të martave në ora 11:00, kërkoj që të shtyhen mbledhjet e Komisionit për në ora 12:00.

Visar Ymeri – e përkrahu znj.Selmani, për shkak se është kryetar i Grupit parlamentar i Vetëvendosjes dhe duhet të merr pjesë në mbledhjet e Kryesisë.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Koha e mbledhjeve të Komisionit të harmonizohet dhe të caktohet në baze të kërkesave të shumicës së anëtarëve.

b)Çështjet vijuese;

Sala Berisha- Shala - kërkoj nga anëtarët e Grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për miniera dhe minerale, që të jenë me aktive dhe të marrin pjesë gjatë monitorimit të ligjit ose të lirojnë vendin deputetëve të interesuar.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Grupi punues do të vazhdojë në përbërjen e njëjtë si është vendosur me Vendim të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit